



FI-Bulletin

Zyrat e këshillimit dhe hotlines

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Zyrat e këshillimit në Kantonin e Cyrihut janë dhe në kohën e krizës së Koronës në mënyrë telefonike në dispozicionin tuaj. Këtu gjeni një përmbledhje të qendrave të rëndësishme të këshillimit dhe hotlines në kantonin e Cyrihut me informacionet në lidhje me temat dhe gjuhët, në të cilat ato këshillojnë.

Këshillimi specifik për Emigracionin

→ [Infodona: 044 412 84 00](#)

Infodona ofron këshillime pa pagesë në temat e mëposhtme: informacione në lidhje me masat rreth virusit koron, jetën në Cyrih, bashkëshortësia dhe familja, e drejta, financat, puna dhe shëndeti. Zyra e këshillimit për emigrantet dhe emigrantët e qytetit të Cyrihut ju informon në 16 gjuhë:

Gjermane, shqipe, arabe, angleze, franceze, italiane, kroate, portugeze, serbe, spanjolle, tamile, turke, sllovaqe, ruse, kurde (sorani) dhe turkmene (Irak).

→ [Këshillimi për emigrantet dhe emigrantët e qytetit Wintertur dhe rrethina: 052 267 36 93](#)

Këshillimet në gjuhën amtare ju informojnë në lidhje me temat specifike të emigranteve dhe emigrantëve si dhe për masat e nevojshme për koronën. Ato janë pa pagesë për banoret dhe banorët e qytetit Wintertur dhe rrethinat dhe ofrohen në gjuhët e mëposhtme:

Shqipe, arabe, ahmare, bullgare, boshnjake, angleze, italiane, kurde, spanjolle, portugeze, serbe, kroate, tamile, maqedonase, tigrine dhe turke.

→ [Zyra mbështetëse e integrit, qyteti i Cyrihut: 044 412 37 37](#)

Zyra mbështetëse e integritit e qytetit të Cyrihut këshillon pa pagesë në lidhje me pyetjet e emigracionit dhe integritit në gjuhët:

Gjermane, angleze, franceze, greke, italiane, portugeze dhe spanjolle. Kjo ofertë ju drejtohet personave që banojnë në qytetin e Cyrihut.

→ [MIRSAH \(Qendra e këshillimit për të drejtën e emigrimit dhe integritit\): 044 291 00 15](#)

Qendra e këshillimit ju informon për pyetjet në lidhje me të drejtën e emigrimit dhe të integritit (p. sh. e drejta e qëndrimit, e bashkimit familjar, leja e punës, viza, marrja e shtetësisë etj.). Juriste dhe juristë të specializuar ju ofrojnë këshillime ligjore kompetente për pyetjet në lidhje me të drejtat e të huajve. Këshillimi kushton 50 CHF në orë dhe ofrohet në gjuhët e mëposhtme:

Gjermane, angleze, franceze, kurde, spanjolle dhe turke.

→ [ZüRAS \(Pika e kontaktit për racizmin në Cyrih\): 044 415 62 26](#)

Pika e kontaktit për racizmin në Cyrih ZüRAS ofron këshillime për personat e prekur nga diskriminimi dhe racizmi në punë, në lagje ose në kohën e lirë për shkak të prejardhjes, ngjyrës së lëkurës ose besimit fetar. Këshillimet janë pa pagesë për personat që banojnë në kantonin e Cyrihut dhe ofrohen në të paktën 9 gjuhë:

Gjermanisht, anglisht, frëngjisht, italisht, rumanisht, portugalisht, suedisht, hungarisht dhe persisht dhe, nëse kërkohet, gjuhë të tjera.

→ [SPAZ \(Pika e kontaktit për personat pa dokumente në Cyrih\): 043 960 87 77](#)

Pika e kontaktit të personave pa dokumente në Cyrih SPAZ këshillon pa pagesë emigrantet dhe emigrantët pa status qëndrimi të përcaktuar në lidhje me pyetjet në fushën sociale dhe të së drejtës në gjuhët:

Gjermane, angleze, franceze dhe spanjolle.

Këshillime të përgjithshme

→ [Këshillimet SOS nga SRK: 044 360 28 53](#)

Punonjës socialë me përvojë këshillojnë persona në situata të vështira, të cilët kanë nevojë urgjente për ndihmë. Kjo pavarësisht nga prejardhja e tyre ose statusi i qëndrimit. Kjo ofertë ju drejtohet personave që banojnë në kantonin e Cyrihut. Këshillimi është pa pagesë dhe ofrohet në gjuhët e mëposhtme:

Gjermane, franceze, angleze, italiane dhe spanjolle.

→ [Këshillim social dhe këshillim mbi borxhet nga Caritas: 044 366 6828](#)

Punonjësit social të Karitasit të Cyrihut ofrojnë këshillim për personat me të ardhura të pamjaftueshme, që jetojnë në varfëri apo që kanë borxhe.

Konsultimet janë falas dhe zhvillohen në gjermanisht.

Këshillime në lidhje me krizën korona

→ [AOZ-Hotline për refugjatët:](#)

Këshilluese dhe këshillues në gjuhën amtare ju informojnë për të reja aktuale dhe masat shoqërore si pasojë e krizës korona në 11 gjuhë:

Arabe, badine, Dari, Farsi, Urdu, angleze, franceze, kurmanci, turke, tamile dhe tigrinja. Këshillimi është në dispozicion të refugjatëve në kantonin e Cyrihut pa pagesë.

→ [Fondacioni i ndihmës së Kishës Evangjeliste Telefoni i ndihmës: 044 360 88 55](#)

Punonjës socialë me përvojë ofrojnë këshillime nëpërmjet telefonit për njerëzit që janë të mbingarkuar në përballimin e të përditshmes gjatë krizës së koronës. Kjo ofertë është pa pagesë dhe ju drejtohet personave që banojnë në kantonin e Cyrihut.

Në telefon do të përgjigjet në **0800 266 785** në 10 gjuhë:

Shqip, Arabisht, Boshnjakisht/Kroatisht/Serbisht, Kurde, Farsisht, Portugeze, Spanjisht, Tamile, Tigrinya, Turqisht.

→ [COACHING CORONA:](#)

Trajnerë profesionistë, ndërmjetëse dhe ndërmjetës si dhe psikologe dhe psikologë këshillojnë njerëz që janë të mbingarkuar në situatën aktuale dhe kanë nevojë për një bashkëbisedim. Për personat e prekur, të afërmit si persona profesionist të shëndetit por dhe si prindër dhe familje.

Bisedat këshilluese zhvillohen në gjermanisht, frëngjisht dhe anglisht dhe janë pa pagesë deri në fund të qershorit 2020

Këshillimet për pyetjet në lidhje me shëndetin

→ [Ärztefon \(Telefoni i mjekut\): 0800 33 66 55](#)

24 orë numri i urgjencës për virusin korona.

→ [MEDITRINA \(Pikë kontakti mjekësore për personat pa dokumente \(personat pa të drejtë qëndrimi në Zvicër\): 044 360 28 72](#)

Meditrina është një Pikë kontakti mjekësor për personat pa dokumente (personat pa të drejtë qëndrimi në Zvicër) të cilët nuk kanë sigurim shëndetësor. Të gjitha këshillimet dhe trajtimi bazë mjekësor në Meditrina është pa pagesë dhe ofrohet në gjuhët e mëposhtme:

Gjermane, angleze, franceze, italiane, portugeze dhe spanjolle. Sqarimet dhe trajtimet në qendrat e jashtme kryhen kundrejt pagesës.

Hotlines

→ [Coronavirus-Hotline: 0800 044 117](#)

Linja e informimit të kantonit të Cyrihut për pyetjet në lidhje me epideminë në kantonin e Cyrihut. Çdo ditë nga ora 7 - 23.

→ [Infoline Coronavirus: 058 463 00 00](#)

Linja e informimit 24-orë e Zyrës Federale të Shëndetit rreth epidemisë në Zvicër. Jo këshillim mjekësor.

FI-Bulletinin mund ta gjeni edhe në [website](#) e Zyra e specializuar për integrim të Kantonit.